



Pse therim kurban?

Cili është gjykimi për të?

Cilat janë mirësitë e tij?

Rregulla mbi kurbanin.

Kafshët që theren për kurban.

Për sa vetë mjafton kurban?

Ç'tuhet gjatë therjes?

Si ndahet kurban?

Me emrin e Allahut të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit.

Falënderimi i takon vetëm Allahut i Cili e pason vështirësinë me lehtësim. Allahun e falënderojmë për shpagimin që i bëri Ismailit (alejhi selam) me një dash të madh. E falënderojmë Atë që na bëri pasues të Muhamedit (alejhi selam) e bashkë me të, ndjekës të Ibrahimit (alejhi selam), babait të profetëve.

Muslimanët e konceptojnë kurbanin si:

Ringjallje të traditës së Ibrahimit (alejhi selam), prijësit të njëjësuesve.

Allahu i Madhëruar e bëri prerjen e Kurbanit, si rikujtim për ngjarjen që i ndodhi Ibrahimit (alejhi selam) dhe të birit të tij Ismailit (alejhi selam), si dhe për të treguar se nëse Allahu kërkon diçka

prej robit të Tij, zbatimi i këtij urdhri duhet të jetë më i dashur për besimtarin sesa vetë ai, se pasuria e tij dhe se mbarë bota.

Allahu me këtë ngjarje na tregon se sprova është traditë e pandryshueshme, e sa më e madhe dhe e rëndë të jetë ajo, aq më e lartë është grada e këtij njeriu tek Allahu i Madhëruar. Ja se si e paraqet Allahu i Madhëruar këtë ngjarje në Librin e Tij Famëlartë:- **"Kështu Ne e përgëzuam Ibrahimin me një djalë të mirë e të sjellshëm."** Kur djali (Ismaili) arriti të angazhohet me të atin (Ibrahimin) në jetë, Ibrahim tha:- **"O biri im! Pashë në ëndërr (shpallje) se po të bëja Kurban. Shiko pra, çfarë mendon ti? Ismaili tha: "O babai im! Bëje atë që je urdhëruar, se mua inshaAllah (në dashtë Allahu) do të më gjesh durimtar."** E kur ata u dorëzuan plotësisht ndaj urdhrit të Allahut, e më pas e përmbysi (me ballin përtokë) për ta bërë Kurban. E thirrëm: O Ibrahim! Ti e përmbushe ëndrrën (zbatove urdhrin). Ne kështu i shpërblejmë bamirësit. Në të vërtetë kjo ishte një sprovë e madhe dhe e qartë. Ne e shpaguam Ismailin me një Kurban të madh. E lamë përkujtimin e tij ndër brezat dhe popujt e ardhshëm." Es-Safat 101-108

E pra, Kurban është tradita e babait tonë Ibrahimit (alejhi selam), Ismailit (alejhi selam) dhe synet i të Dërguarit të Allahut Muhamedit (alejhi selam).

Nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij) transmetohet se: i Dërguari i Allahut (alejhi selam) ka bërë Kurban me dorën e tij dy deshë të bardhë me disa pulla të zeza, të majmë e me brirë. Tha:- Bismilah, Allahu Ekber dhe e vendosi këmbën e tij mbi qafët e tyre kur i theri." Transmeton Buhariu dhe Muslimi

E që nga ajo kohë vazhdon tradita e do të vazhdojë kudo që të ketë muslimanë.

Rizgjim i teuhidit të fshehur në zemra

Therja e Kurbanit për hir të Allahut është specifike e një besimtari. Besimtari e ka të ndaluar të ushqehet prej mishit që në therjen e tij nuk është përmendur emri i Allahut. Po kështu edhe prej atij mishi gjatë therjes së të cilit është përmendur ndonjë emër tjetër veç emrit të Allahut, apo prej atij kurbanit që i drejtohet dikujt tjetër veç Allahut, qoftë ky "shenjtor", "njeri i mirë", "vend i mirë", varr, dru, gur, pejgamber, melek etj.

Në lidhje me këtë Profeti (alejhi selam) në hadithin të cilin e transmeton Imam Muslimi në Sahihun e tij thotë:- **"Allahu e ka mallkuar atë njeri që pret Kurban për hir të dikujt tjetër veç Allahut".**

Në një hadith tjetër thotë:- **"Kush vdes dhe ka bërë Kurban jo për Allahun është në zjarr."**

Allahu i drejtohet të Dërguarit të Tij duke thënë:- **"Thuaj (O Muhamed):- në të vërtetë namazi im, Kurbanimi im, adhurimet e mia, jeta dhe vdekja ime janë për Allahun Zotin e botërave."** En-Am 162

Përkujdesje të besimtarit në pasimin e udhëzimit të Profetit.

Siç u përmend më lart me therjen e kurbanit ne pasojmë të Dërguarin e Allahut (alejhi selam) e

pa këtë kusht, pra pasimin e Profetit (alejhi selam) nuk pranohet asnjë vepër, siç thotë Allahu i Madhëruar:- **"Allahu është Ai i Cili e krijoi jetën dhe vdekjen, për t'ju sprovuar se kush i bën punët më të sakta (ashtu siç ka bërë i Dërguari i Allahut (alejhi selam))."** Mulk 2

Bindje se Allahu i Madhëruar është absolut në cilësitë e Tij të Larta dhe se me adhurimet tona i bëjnë dobi vetëm vetes sonë. Pikërisht për këtë Allahu i Madhëruar në hadithin Kudsij thotë:- **"O biri i Ademit! Nëse të gjithë ju, pa përjashtim; njerëzit, xhinët, jeni aq të këqij sa më i keqi prej jush, kjo nuk do të pakësonte asgjë nga sundimi im. O biri i Ademit! Ti nuk mund të bësh ndonjë të mirë që të më bëjë dobi. As nuk mund të bësh ndonjë të keqe që të më dëmtosh."**

Prandaj Allahu këtë veprim e ka konsideruar si falënderim ndaj begative të tij të panumërta, siç thotë Allahu:-**"Ne i kemi përcaktuar çdo populli, vende adhurimi (si vendi i therjes së Kurbanit pikërisht Minaja), që ta pëmendin emrin e Allahut për arsye se i furnizoi (ushqeu) ata me to (kafshët). Zoti juaj është një Zot i Vetëm, të Cilit i takon adhurimi, vetëm Atij dorëzohuni (duke pranuar islamin), përgëzoji të nënshtruarit, të dorëzuarit ndaj Allahut në Islam si besimtarë të vërtetë."** Haxh 34

Madje, pikërisht për Kurbanin Allahu thotë:- **"Nuk arrin tek Allahu as mishi, as gjaku i këtyre kafshëve të therura por arrin devotshmëria, bindja juaj"** El Haxh 37

Gëzim për të varfëritë dhe të vobektët

Kjo arrihet nëse ai musliman i pasur që ka bërë Kurban i jep edhe vëllait të tij.

Allahu thotë:- **"Hani prej tyre (Kurbaneve) e ushqeni të varfrin që lyp e atë që nuk lyp."** El Haxh 37

Shtim të lidhjeve ndërmjet vëllezërve.

Kjo arrihet sepse njeriu mund t'i dhurojë nga Kurbanin i tij edhe atij që është i pasur, fqinjit, dikujt që e do për hir të Allahut e kështu me radhë.

Të parët tanë të mirë pëlqenin që Kurbanin ta ndanin në tre pjesë; 1/3 e jepnin sadeka, 1/3 e dhuronin dhe 1/3 e mbanin për veten e tyre.

Falënderim për Allahun

Allahu na ka furnizuar me begati nga më të ndryshmet të cilat luajnë rolin kryesor në rimëkëmbjen dhe rigjallërimin e trupit nga fuqitë e harxhuara, e s'ka dyshim se prej ushqimeve më të rëndësishme është edhe mishi i kafshëve. Shiko se si Allahu i ka bërë këto kafshë për t'i shërbyer njeriut në misionin e lartë që ka marrë mbi supe.

Profeti (alejhi selam) thotë në hadithin të cilin e transmeton Muslimi:- **"Në të vërtetë kërkojmë ditë ngrënie, pirje, dhe të përmendjes së Allahut."**

Gjykimi për Kurbanin

Kurbani është obligim për atë që ka mundësi, duke u mbështetur në thënien e Allahut:- **"Falu për hir të Zotit tënd dhe bëj Kurban për hir të Tij."** El-Keuther 2

Në një hadith thuhet se Profeti (alejhi selam) ka therur kurban dhe ka thënë:-

"O Allah e bëj këtë Kurban për Ty dhe e paraqes për veten time dhe për të gjithë ata që nuk bëjnë kurban nga ymeti im." Prandaj u bë si kusht mundësia se i Dërguari i Allahut (alejhi selam) thotë në një hadith tjetër të cilin e transmeton Hakimi dhe Ibn Maxheh:- "Kush nuk bën Kurban mos t'i afrohet vendfaljes tonë."

Mirësia e Kurbanit

I dërguari i Allahut (alejhi selam) ka thënë:- **"Nuk ka ndonjë punë më të dashur tek Allahu sesa derdhja e gjakut të kafshës. Ajo do të vijë në Ditën e Gjyimit me brirët, leshin e thundrat e saj, (si dëshmitare e kësaj vepre të mirë). Gjaku ka vend tek Allahu përpara se të bjerë në tokë."** Tirmidhiu ka thënë se hadithi është Hasen.

Disa rregulla mbi Kurbanin

Çfarë duhet të bëjë personi që do të therë Kurbanin?

Ai i cili ka bërë nijet të therë Kurban, me futjen e hënës së Dhul Hixhes, nuk duhet të presë flokët, e as thonjtë se i Dërguari i Allahut (alejhi selam) ka thënë në hadithin që e transmeton Muslimi:- **"Nëse shikoni hënën e Dhul Hixhes, e ndonjëri prej jush dëshiron të therë Kurban, të mos i presë thonjtë dhe flokët e tij."**

Nëse dikush vendos për të bërë Kurban pasi ka hyrë muaji i Dhul-Hixhes, atëherë, që nga koha kur bën nijet derisa ta therë Kurbanin zbaton ato që thamë më lart.

Kafshët që theren për Kurban

Bagëtitë, qofshin bagëti të trasha apo të imëta pra: lopët, devetë, delet, dhitë.

Mosha

Muslimi në Sahihun e tij transmeton se i Dërguari i Allahut (alejhi selam) ka thënë:- **"Therni vetëm ato dele që e kanë mbushur vitin, e nëse nuk keni mundësi, therni gjashtë muajshe."**

Cilësitë

Kurban bëhen vetëm ato kafshë të cilat janë pa këto të meta: e verbër, me dy sy apo me një, e sëmurë që dallohet, e çalë, me brirë të thyer gjer në rrëzë, me vesh të prerë, e dobët shumë, e vjetër si dhe e tërbuar. Këto cilësi përmenden në hadithin që e transmeton Imam Ahmedin në Musnedin e tij, Ebu Daudi, Tirmidhiu.

Kurbani më i mirë

Kurban më i mirë është Kurban i majmë, me brirë siç e ka cilësuar i Dërguari i Allahut (alejhi salam) dhe me të tillë ai vetë ka bërë Kurban. Hadithin e transmeton Buhariu dhe Muslimi nga Enesi (Allahu qoftë i kënaqur prej tij), se i Dërguari i Allahut (alejhi salam):- **"Ka bërë kurban dy deshë, me brirë, të majmë, të bardhë me disa pulla të zeza."**

Ndërsa në hadithin tjetër është cilësuar; **"Me brirë, të rrethuar me pulla të zeza, barku, këmbët dhe rreth syve me të zezë."** Siç ka thënë Imam Neveui në shpjegimin e hadithit në Sahihun e Muslimit.

Pëlqehet të shëndoshet e të mbahet mirë, kjo duke u mbështetur në thënien e Allahut në suren Haxh 32. **"Kushdo që i nderon, vlerëson simbolet (e fesë) së Allahut, ky është argumenti i devotshmërisë që fshihet në zemra."**

Ibnu Huzejmeh ka thënë:- **"Sa më i shtrenjtë aq më shumë shpërblim tek Allahu i Madhëruar."**

Koha dhe mënyra e therjes

Mendimi i të gjithë dijetarëve është se koha fillon në mëngjesin e Bajramit pas faljes së namazit.

Transmeton Muslimi se i Dërguari i Allahut (alejhi salam) ka thënë:- **"Kush e ka therur Kurbanin përpara namazit, le të therë tjetër pas namazit, e kush e ka therur pas namazit i ka plotësuar adhurimet dhe e ka qëlluar traditën e muslimanëve."**

Në një hadith tjetër thuhet:- **"Të mos bëjë askush (Kurbanin) vetëm pasi ta ketë falur namazin (e Bajramit)."** Muslimi

Përsa i përket mënyrës së therjes, kafshës duhet t'i priten rrugët e frymëmarrjes, të ushqimit si dhe dy damarët kryesorë pa e prekur palcën e shtyllës kurrizore.

I Dërguari i Allahut e vendoste këmbën e tij mbi qafën e kurbanit. Ibn Haxheri ka thënë:- **"Të gjithë dijetarët kanë rënë dakord që të hidhet kafsha në të majtë. I vendoset këmba nga e djathta në mënyrë që ta vendosë këmbën mbi të e ta marrë thikën me të djathtën duke ia mbajtur kokën bagëtisë me të majtën".**

Për sa është i mjaftueshëm Kurban?

Një dele për një familje, një lopë a deve për shtatë familje.

Një nga bagëtitë e imëta është më e mirë për një familje sesa një lopë apo deve për shtatë familje. Një lopë apo deve për një familje, është më e mirë sesa një bagëti e imët për një familje. Ibn Xhibrin

Çfarë thotë ai që e pret Kurbanin

"Bismilahi Uallahu Ekber, Allahume tekabel minij ue ehli bejtij."

"Me emrin e Allahut, Allahu është më i Madhi. O Allah pranoje prej meje dhe familjes sime." siç thuhet në hadithin që e transmeton Buhariu dhe Muslimi.

Ibnul Kajimi ka thënë:- **"I dërguari i Allahut ka urdhëruar umetin që të jenë të mëshirshëm (bamirës) edhe në therje siç transmeton Muslimi në sahihun e tij se i Dërguari i Allahut ka thënë:- "Allahu e ka bërë obligim bamirësinë ndaj çdo gjëje, kështu që nëse vrisni, lehtësoni, nëse thërrni, lehtësoni."**

Ta mprehtë mirë thikën gjithësecili prej jush e të mos e mendojë kafshën por ta therë në mënyrën më të mirë."

Lejohet që përgjegjësia e therjes t'i jepet dikujt tjetër pa harruar se më e mira është ta bëjë vetë.

Ndarja e kurbanit

Pëlqehet që kurbanit të ndahet në tri pjesë 1/3 për familjen, 1/3 për dhuratë 1/3 për sadaka. Kështu vepronin edhe të parët tanë të mirë.

Në një transmetim të Muslimit thuhet se Profeti (alejhi selam) ka thënë:- **"Hajeni, ruajeni dhe jepeni sadaka".**

Shpërblimi i kasapit

Aliu radiallahu anhu ka thënë:- **"Më ka ndaluar i Dërguari i Allahut që t'i jap kasapit diçka nga kurbanit dhe më tha:- "Ne i japim shpërblim nga ana jonë" Buhariu dhe Muslimi.**

Së fundi rikujtojmë se për të bërit fli apo sakrificë nuk mjafton vetëm derdhja e gjakut por edhe sinqeriteti që e fshehin zemrat.

Përgatiti: Ahmed Kalaja - Klubikulturor